



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 341 / prot.

Gramsh, më 23 / 01 / 2024

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak;
Të nderuar këshilltarë, Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për funksionimin e Këshillit Bashkiak Gramsh”, njoftoj se mbledhja e muajit JANAR do të zhvillohet ditën e **PREMTE datë 26/01/2024 ora 10:00 në sallën kati II Pallati i Kulturës, me rend dite si më poshtë:**

- 1- Për miratimin e Dhënies së Mandatit të këshilltarit të Këshillit të Bashkisë Gramsh. (Kryetari i Këshillit)
- 2- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin DHJETOR 2023 (fondi 6%) (Sek.Ndih..Sociale)
- 3- Për miratimin e kontrtës së “Shërbimit publik për pranimin, depozitim dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Gramsh” në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, MIDIS Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. (Përgjegjësi i Mjedisit).
- 4- Për miratimin e përfundimit të procesit të zgjedhjes së kryesive dhe kryetarëve në 3 fshatra të Njësisë administrative Kukur të Bashkisë Gramsh dhe afatin e nisjes për shpërblimin e tyre. (Sek.Këshillit).
- 5- Për miratimin e Raportit të Komisionit të Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Ligjore dhe Administrative. (Komisioni)
- 6- Për administrimin e kullotave dhe livadheve si dhe dhënien e tyre me qera fermerëve fizike e juridike me anë të kontratave qiramarrëse. (Dr.Shërb.PyJOR&Mjedisit)
- 7- Mbi mundësinë e përdorimit të sipërfaqeve të fondit pyJOR dhe kullosor, si dhe miratimin në parim të dhënies në përdorim/heqjes të sipërfaqeve të fondit pyJOR dhe kullosor në pronësi të bashkisë Gramsh. (Dr.Shërb.PyJOR&Mjedisit)
- 8- Për miratimin e kërkesave për subvencionim të qirasë për disa familje në nevojë, bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore. (Sek.Emergj.Civile&Strehimit)
- 9- Për një shtesë orari në linjën e transportit rrethqytetës Gramsh – Vidhan dhe anasjelltas. (Sek.të Ardhurave nga Biznesi&Transporti)
- 10- Kërkesa të qytetarëve, Të tjera.

Duke ju falenderuar!

SEKRETARI I KËSHILLIT
Xhulia GJINI

